ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOLEGJI PUBLIK NDËRKOMBËTAR I BIZNESIT (IBCM)**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr. i Prokurimit[1]	**208/97950-26-4388-1-3-6**
Nr i brendshëm	**IBCM97950-26-025-136**

Sa i përket tenderit për: **Furnizim me pajisje për qendrën e inovacionit dhe biznesit ne IBCM**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

INFINITT SH.P.K
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr.28 Nentori, no.121
(Adresa)

Prishtinë *10.000*
(Vendi) *(Kodi postar)*
044/974-590 /
(Numri Telefonit) *(Numri i Faks-it)*

Astrit Uka- menaxher
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë

infinitt.shpk@gmail.com
(Adresa elektronike)

09.11.2026.
(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____/_____
(Emri i avokatit)

_____/_____
(Adresa e plotë)

_____/_____ _____/_____
(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____/_____
(Adresa elektronike)

_____/_____ _____/_____
(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës","Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate: 08.06.2026. Afati i fundit për dorzimin e ofertav: 15.06.2026. Data dhe ora e hapjes se ofertav: 15.06.2026. ora 13:30 Njoftimi mbi vendimin e AK: 21.10.2026. Kriter per dhenie te kontrates: Tenderi i pergjegjshem me cmimin me te ulet

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒ x

Procesverbalin e hapjes se ofertave e kemi pranuar ne e-prokurim

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [x] **Jo** [ ]

Letren standarde per tenderuesin e eleminuar se bashku me njoftimin mbi vendimin e AK i kemi pranuar ne e-prokurim me 21.10.2026.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [x] **Jo** [ ]

Nëse po, ofroni detaje mbi këtë fakt dhe bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se. Kerkesen per ri-shqyrtim te AK kemi paraqitur me 26.10.2026. Vendimin per refuzim te kerkeses per ri-shqyrtim e kemi pranuar 28.10.2026.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1- Qellimi Neni 6- Ekonomiciteti dhe Efikasiteti Neni 7- Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi Neni 28- Specifikimet teknike Neni 52.3- Njoftimi i kritereve për dhënien e kontratës Neni 56.3- Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave Neni 59.3- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi I tendereve Neni 60- Kriteret per dhenie te kontrates Neni 65.5- Pranueshmëria e Kandidatëve ose Tenderuesve Neni 67- Provat Shkresore

Neni 69- Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale
Neni 40 i Rrregullores per prokurim publik- Ekzaminimi, vleresimi dhe krahasimi i tendereve.
Neni 10.1 i UOPP-se/ Sqarimi i tenderëve gjatë procesit të vlerësimit të tenderëve

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

AK/Komisioni vlersues gjatë vlerësimit të ofertave për projektin në fjalë nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 I ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartëcekura dhe Udhëzimin operativ e rregulloren për prokurim publik.
AK/zyra e prokurimit me 21.10. ka nxjere njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues dhe ka rekomanduar per kontrate OE i renditur i dyti TONI O.P.
Me 22.10. kemi kerkuar qasje ne dokumentet zyrtare dhe me 23.10. AK na ka ofruar qasjen sipas kerkeses sone.
Kompania jone eshte eleminuar me arsyetimin se nuk kemi derguar konfirmim per zgjatjen e vlefshmerise se ofertes dhe katalogu i produkteve nuk ploteson specifikat e kerkuara nga AK.
Ky konstatim i AK/komisionit vleresues nuk qendron, cdohere qe AK ka kerkuar deshmine per vazhdimin e vlefshmerise se oferte ne kemi derguar.
Poashtu katalogu i dorezuar me sqarime shtese me 31.08.2026. perkatesisht modeli PRUSA CORE ONE L 3D PRINTER ploteson te gjitha specifikimet teknike si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit.
AK perveq se ka eleminuar pa te drejte kompanine tone, ne anen tjeter ka vendosur te rekomandoje per kontrate OE te papergjegjshem per arsyejet si ne vijim:
OE ka dorezuar File ANEKSI 1 & Katalogu mirepo mes specifikave te dorezuara/ plotesuara ne ANEKS 1 dhe katalogut te produkteve ka mosperputhje ne kete menyre OE eshte dashur te eleminohet si i papergjegjshem pa kerkuar informacione shtese.
Eshte kerkuar printeri me dimensione Printer dimensions 21,9 kg, 469×521×635 mm; 18.5×20.5×25 in (W×D×H) ndersa eshte ofruar sipas katalogut printeri me peshe 23.7kg dhe dimensione 445x477x513cm perderisa AK nuk ka lejuar ndonje perqindje te devijimit OE eshte dashur te ofroje produktin me peshe e dimensione identike si ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit.
Ne katalogun e dorezuar nga OE nuk paraqitet fare specifika Lidhur me diametrin e filamentit dhe Layer Height poashtu nuk jane paraqitur specifikat per Stteper drivers, Stepper motors, Extruder, Drive system, Cooling fan, Prusa conect support, Prusa APP,Filemant sensor, Loadcell sensor, Door sensor, MMU3 support e dhjetera specifika tjera per te cilat nuk jemi ne dijeni se si ka konstatuar komisioni vleresues se i ploteson oferta e OE kur nuk jane te pershkruara ne katalog.
Poashtu OE fare ne katalog nuk ka cekur modelin e printerit te ofertuara dhe perderisa ka mosperputhje mes specifikave te kerkuara nga AK ne ANEKS 1 te dosjes se tenderit

dhe ato te ofertuara nga OE AK eshte dashur te eleminoje OE ne fjale si te papergjegjshem pa kerkuar informacion te metutjeshem.
Prandaj AK duke u bazuar dhe ne UOPP eshte dashur te refuzoje oferten e OE TONI OP pa kerkuar informacione te metutjeshem, citoj
Është dorëzuar katalogu por
mungon specifikacioni teknik
për mallrat e ofruara
Refuzo tenderin pa kërkuar
informacion të mëtejshëm/ Neni 69 i LPP-se.
Bashkangjesim me ankese ne menyre te detajuar specifikat te cilat OE nuk i ka paraqitur ne katalog apo nuk perputhen me kerkesen e AK.

Kërkesa e Aneksit 1	**Katalogu i dorëzuar, faqet 4–5**	**Deshmia**
Teknologji **FDM/FFF**	"Fused Filament Fabrication (FFF), marketed as FDM"	✅ Dëshmohet
Vëllim minimal **300 × 300 × 300 mm**	"Build Volume 30.0 × 30.0 × 30.0 cm"	✅ Dëshmohet
Dhomë e mbyllur	"Build Area Type: Enclosed"	✅ Dëshmohet
Kalibrim/nivelim automatik ose i asistuar	"Build Plate Features: Auto Leveling"	✅ Dëshmohet
Platformë printimi me ngrohje	"Build Plate Features: Heated"; temperatura deri **110°C**	✅ Dëshmohet
Grykë ≥ **300°C**	"Extruder Nozzle Temperature: 300°C"	✅ Dëshmohet
Shpejtësi e rekomanduar ≥ **300 mm/s**	Katalogu paraqet "Print Speed: 600 to 20000 mm/s"	❌ **Nuk dëshmohet**
Kamerë e integruar ose monitorim në distancë	"Monitoring Camera: Yes"	✅ Dëshmohet kamera
USB	"1× Unspecified USB"	✅ Dëshmohet
Wi-Fi dhe/ose Ethernet	"Wireless: Wi-Fi"; "1× RJ45"	✅ Dëshmohet
Ekran touchscreen	"Display: Yes: 4" Touchscreen"	✅ Dëshmohet
Direct-drive ose ekuivalent	Nuk shfaqet	❌ **Nuk dëshmohet**
Sipërfaqe fleksibile ose e largueshme	Nuk shfaqet	❌ **Nuk dëshmohet**
Sensor/detektim i mungesës së filamentit	Nuk shfaqet	❌ **Nuk dëshmohet**
Vazhdim automatik pas ndërprerjes së energjisë	Nuk shfaqet	❌ **Nuk dëshmohet**

Software standard për slicing	Faqja 5 tregon vetëm “Supported 3D File Types: .gcode”	⚠ **Software-i slicing nuk identifikohet/dështmohet**
Ndërfaqe intuitive për përdoruesin/mjedis edukativ	Nuk dështmohet	❌ **Nuk dështmohet**
Sistem inteligjent për menaxhimin e filamentit	Nuk shfaqet	❌ **Nuk dështmohet**
Ndërrim automatik i filamentit	Nuk shfaqet	❌ **Nuk dështmohet**
Printim me shumë ngjyra/materiale	Nuk shfaqet	❌ **Nuk dështmohet**
PLA	Nuk paraqitet lista e materialeve	❌ **Nuk dështmohet**
PETG	Nuk paraqitet	❌ **Nuk dështmohet**
TPU	Nuk paraqitet	❌ **Nuk dështmohet**
ABS	Nuk paraqitet	❌ **Nuk dështmohet**
ASA	Nuk paraqitet	❌ **Nuk dështmohet**
Nylon / material ekuivalent inxhinierik	Nuk paraqitet	❌ **Nuk dështmohet**
Materiale të përforcuara me fibër karboni	Nuk paraqiten	❌ **Nuk dështmohet**
Rezolucion shtresash i përshtatshëm	Nuk paraqitet layer height/resolution	❌ **Nuk dështmohet**
Monitorim automatik/detektim dështimesh	Katalogu dështmon vetëm “Monitoring Camera: Yes”	⚠ Kamera po; **detektimi automatik i dështimeve nuk dështmohet**

Poashtu ka edhe nje pike te mosperputhjes bazike: Ne ANEKS 1 kërkohet shprehimisht TPU, ndërsa lista e materialeve për K2 Pro përmban PLA/ABS/PETG/PA-CF/PLA-CF/PET/ASA/PPA-CF, por TPU nuk figuron.

Ne pergjigje te kerkeses per ri-shqyrtim AK fare nuk ka trajtuar kete pretendim ankimor por vetem eshte cekur vendimi i OSHP-se nr. 2026/676 sipas te cilit lenda eshte kthyer ne ri-vleresim mirepo ky vendim nuk determinon fituesin apo rezultatin e aktivitetit te prokurimit ne ri-vleresim rjedhimisht AK eshte dashur te na trajtoje barabarte e jo te rekomandoj per kontrate OE te papergjegjshem i cili nuk ploteson specifikimet teknike te percaktuara ne dosjen e tenderit.

OE i rekomanduar per kontrate eshte i papergjegjshem pasiqe nuk ka plotesuar kerkesat e peshtatshmerise sipas kerkeses ne dosjen e tenderit dhe konform nenit 65.5 te LPP-se

OE nuk ploteson kriterin pasiqe ka dorezuar certifikaten e gjykates per kompani leshuar me date 31.07.2026. dhe vertetimin e ATK-se me date 22.09.2026.

Keto dokumente nuk mund të konsiderohen dëshmi te vlefshme dhe jane në kundërshtim me kërkesat për pranueshmëri të përcaktuara nga AK.

Autoriteti kontraktues eshte dashur te shqyrtoje se a ploteson OE i rekomanduar kerkesat e pershtatshmerise para dates se ofertimit konform nenit 65.5 te LPP-se dhe

kerkeses ne DT ku eshte specifikuar se dokumentet kerkohen deri ne tremujorin e fundit para publikimit te njoftimit per kontrate.
Në përputhje me nenin 65 paragrafi 5 i Ligjit për Prokurimin Publik, periudha kohore në të cilën Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kriterin e "pranueshmërisë" lidhet drejtpërdrejt me periudhën që menjëherë i paraprin datës së publikimit të njoftimit për kontratë.
Kjo dispozitë ligjore nënkupton se Operatori Ekonomik duhet të jetë i pranueshëm pikërisht në datën e publikimit të njoftimit për kontratë dhe jo pas kësaj date.
Në rastin konkret, kërkesa e AK ka qenë e vendosur në përputhje të plotë me nenin 65, paragrafi 5 i LPP-së, ndërsa dokumentet përkatëse Vertetimi i Administratës Tatimore dhe Certifikata e Gjykate do të duhej të ishin të lëshuara para ose deri ne diten e hapjes se ofertav.
Dorëzimi i vertetimit te ATK-se dhe certifikates se gjykates pas kësaj date nënkupton se Operatori Ekonomik do të mund të bëhej "i pranueshëm" vetëm pasi të ishte vënë në dijeni për rezultatin e procedurës, gjë që është në kundërshtim me parimet e barazisë së trajtimit, transparencës dhe konkurrencës së ndershme në prokurimin publik.
Operatorët Ekonomikë të interesuar për këtë aktivitet të prokurimit duhet të jenë të rregullt në përmbushjen e obligimeve tatimore para datës së publikimit të njoftimit për kontratë, duke dëshmuar kështu stabilitetin dhe likuiditetin e tyre ekonomik.
Në përputhje me nenin 67, paragrafi 2 të LPP-së, AK ka obligim ligjor të vlerësoj të papërgjegjshëm çdo tenderues i cili nuk paraqet certifikatat apo dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar se nuk shkualifikohet sipas nenit 65 të këtij ligji.
Nga shqyrtimi i fakteve rezulton se tenderuesi ankues nuk ka dorëzuar dëshmi në pajtim me kërkesat e nenit 65 të LPP-së, ashtu siç janë kërkuar në Njoftimin për Kontratë dhe DT.
Lidhur me kete qeshtje komisioni rregullativ per prokurim publik ka nxjere interpretim ligjor me 22.11.2022. citojme interpretimin nr 6.

6. 22.11.2022 A duhet OE me rastin e dorëzimit të ofertës të dëshmojnë se nuk janë në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së?

Konform nenit 87, paragrafit 2, nën-paragrafit 2.8 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në pyetjet e parashtruara, KRPP ofron interpretimin ligjor të nën paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, si në vijim: Paragrafi 4.8 i nenit 65 te LPP përcakton: 4.8 "aktualisht është me vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë ose në vendin e themelimit të operatorit ekonomik, përveç ku një borxh i tillë është vërtetuar të jetë jo i rëndësishëm në Kosovë;" Në kuptim të paragrafit 4.8 të nenit 65 të LPP-së, termi "aktualisht" nënkupton çdo herë që kërkohet në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë dëshmi për të vërtetuar se OE nuk është në vonesë në pagimin e çfarëdo kontributeve për sigurim social apo tatim në Kosovë, OE duhet të sjellë dëshminë për të vërtetuar se një gjendje e tillë nuk ekziston. Për këtë qëllim, në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë kërkohet nga të gjithë OE-të të interesuar për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit që të deklarojnë se janë "të pranueshëm" për të marrë pjesë në aktivitetin e prokurimit. OE- të janë "të pranueshëm" kur ata ofrojnë së bashku me tenderin e tyre dëshminë "Deklaratën nën betim" me të cilën deklarojnë se një gjendje e tillë nuk ekziston. Kur OE rekomandohet për dhënie të Kontratës, para publikimit te Njoftimit mbi Vendimin e AK-se, nga i njëjti kërkohet dëshmia "Vërtetimi nga ATK" dhe për të qenë "i pranueshëm" OE sipas nenit 65 të LPP-së, duhet të vërtetojë se nuk është në vonesë në pagimin e tatimeve ndaj ATK-së. Ne përputhje me paragrafin 5 te nenit 65, periudha kohore, se në cilën periudhë duhet të jetë OE i "pranueshëm", ndërlidhet me periudhën që menjëherë paraprinë datën e publikimit të njoftimit të kontratës, që do të thotë

se OE duhet të jetë i "pranueshëm" në datën e publikimit të njoftimit. Borxhet mund të lindin në periudha të ndryshme p.sh. gjatë procesit të vlerësimit, gjatë fazës së ankimimit, prandaj ky nen përcakton kohen kur OE duhet të jetë i pranueshëm. Nisur nga fakti se shumë OE kanë marrëveshje për shlyerje të borxheve me ATK-në, KRPP sqaron se edhe në këtë rast marrëveshjet për shlyerje të borxheve duhet të jetë para datës së publikimit të njoftimit të kontratës. Qëllimi i këtij neni është që OE duhet të jetë gjithmonë "i pranueshëm", pra OE nuk duhet të ketë obligime të pashlyera në kohen e publikimit të Njoftimit për kontratë.
Pasiqe jemi ballafaquar me situate te njejte ne AK tjera bashkangjesim interpretimin e KRPP-se te leshuar lidhur me kete qeshtje me 11.03.2026.
Poashtu pasiqe kemi paraqitur ankese ne OSHP me pretendime te njejta ankimore citojme vendimin nr. 2026/353 te dates 01.06.2026.
Mare parasysh faktet e lartecekura konstatojme se AK/komisioni vleresues ka rekomanduar per kontrate OE te papergjegjshem ne aspektin administrativ dhe ne anen tjeter ka eleminuar pa te drejte oferten e kompanise sone megjithese kemi plotesuar te gjitha specifikimet teknike per printer te percaktuara nga AK.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Si pasoje e shkeljeve te lartecekura nga AK/komisioni vleresues ka ardhe deri tek dhenia e kontrates per OE te papergjegjshem, kompanise sone si oferta e pergjegjshme me cmimin me te ulet ne kete aktivitet te prokurimit i eshte mohuar e drejta e fitimit te paramenduar nga kjo kontrate si dhe eshte demtuar buxheti publik perkatesisht Kolegjit ICBM duke u rekomanduar per kontrate OE me cmim reth 40% me te larte se oferta e kompanise sone.
Kerkojme nga Organi shqyrtues i prokurimit qe pas shoshitjes se provave dhe fakteve te aprovoje ankesen e kompanise sone si te bazuar dhe lenda te kthehet ne ri-vleresim.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*